

V E N D I M
Nr.291, datë 29.5.1995

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.345, DATË
10.8.1992 “PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS SË PUNONJËSVE”**

Me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.345, datë 10.8.1992, ndryshuar me vendimin nr.344, datë 9.7.1993, pas pikës 10, shtohet pika 10/a me këtë përmbajtje:

- “Nëse bashkësitë ekonomike të sistemit të Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike e rritin pagën mesatare mujore nga 5 deri në 70 për qind mbi masën e rritjes në përqindje të miratuar nga Këshilli i Ministrave, në raport me realizimin gjithsej të kriterëve financiarë të vitit ushtrimor, si detyrimet tatimore ndaj buxhetit të shtetit, derdhja e kredive dhe interesave bankare, shlyerja e kontributit të sigurimeve shoqërore, përkrahja sociale dhe detyrimet për energjinë elektrike të papaguar në afat, nuk zbatohet asnjë sanksion.

- Nëse bashkësitë ekonomike të sistemit të Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike e rritin pagën mesatare mujore nga 5 deri në 70 për qind mbi masën e miratuar në përqindje nga Këshilli i Ministrave jo në përputhje me raportin e realizimit gjithsej të kriterëve financiarë të përcaktuara në paragrafin e mësipërm, detyrohen të derdhin në buxhetin e shtetit një pjesë të fitimit, baras me 500 për qind të kësaj rritjeje”.

2. Kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi zbatohen për detyrimet që lindin nga veprimtaria financiare e bashkësive ekonomike të sistemit të Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike brenda vitit ushtrimor, në varësi nga mënyra e kontrollit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga data 1.1.1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi